BULETIN JAVOR
4-8 SHTATOR 2023

Shprehja e javës

"Nuk ka asnjë teknologji sot që nuk mund të mposhtet nga inxhinieria sociale."

Frank Abagnale

Përmbajtja:

- **Autoriteti Kombëtar për CESK, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Igli Tafa, pjesëmarrës në Tallinn Digital Summit.**
- **Autoriteti Kombëtar për CESK, pjesë e festivalit Innovation Nest Tirana**
- **AKCESK Pjesmarrëse E Raportimit Të Shqipërisë Për Zbatimin E Konventës Së Organizatës Së Kombeve Të Bashkuara, Mbi Të Drejtat E Fëmijës**

Autoriteti Kombëtar për CESK, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Igli Tafa, pjesëmarrës në Tallinn Digital Summit.

Në panelin "Western Balkan Digital Security", kreu i AKCESK prezantoi sfidat e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar pas sulmeve të sofistikuara të një viti më parë, duke theksuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe mbështetjen e partnerëve strategjikë ndërkombëtarë, për adresimin e tij.

Gjithashtu, në fjalën e tij Z. Tafa theksoi rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve, fuqizimit të aspekteve të diplomacisë kibernetike, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit, si prioritete kyçe për krijimin e një ekosistemi kibernetik të qëndrueshëm.
Samiti, i organizuar nga Qeveria Estoneze, nën kujdesin e Kryeministrit Kaja Kallas, mblodhi përfaqësues të rëndësishëm të fushës së sigurisë kibernetike, me qëllim forcimin e bashkëpunimit, adresimin e sfidave dhe identifikimin e mundësive të reja, për një të ardhme digjitale më të sigurt.

AKCESK, pjesë e festivalit të parë të inovacionit në Tiranë, nën sloganin "Lidhuni me Botën", "Lidhuni me Njëri-Tjetrin" dhe "Lidhuni me të ardhmen".

Në datat 8-9-10 Shtator, pranë Parkut Olimpik u organizua festivali Innovation Nest Tirana, ku vizitorët në stendën e Autoritetit u informuan për të rritur ndërgjegjësimin në fushën e sigurisë kibernetike!

Gjatë ditës së dytë të festivalit AKCESK ndërgjegjësoi pjesmarrësit mbi Data Privacy dhe Cybersecurity në E-commerce

AKCESK Pjesmarrëse E Raportimit Të Shqipërisë Për Zbatimin E Konventës Së Organizatës Së Kombeve Të Bashkuara, Mbi Të Drejtat E Fëmijës

AKCESK ishte pjesë e raportimit të Shqipërisë për zbatimin e Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, mbi të Drejtat e Fëmijës gjatë punimeve të sesionit të 94-t, të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, mbajtur në Gjenevë, në datat 4-5 shtator 2023.

Në linjë me angazhimet e marra nga shteti Shqiptar në terma të zbatimit të kësaj Konvente, AKCESK raportoi mbi hapat konkretë të ndërmarrë për krijimin e një ekosistemi kibernetik të sigurt për fëmijët dhe të rinjtë.

Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve në mjedisin online është një ndër shtyllat kryesore të "Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike" dhe Planin e Veprimit, ku AKCESK në rolin e institucionit drejtues ka bashkërenduar punën me institucionet e tjera përgjegjëse, duke organizuar në vazhdimësi fushata ndërgjegjësimi, trajnime dhe aktivitete të ndryshme me fëmijët dhe të rinjtë, prindërit, mësuesit, punonjësit e mbrojtjes sociale, punonjësit e Policisë së Shtetit dhe aktorë të tjerë të fushës, në mënyrë që të arrihet qëllimi kryesor, për të krijuar një ekosistem të sigurt për fëmijët dhe të rinjtë online.

AKCESK, theksoi nevojën e ndërgjegjësimit dhe mënyrat e mbrojtjes ndaj kërcënimeve të shtuara dhe të vazhdueshme që përballen fëmijët dhe të rinjtë online, si dhe nevojën e vazhdueshme për bashkëpunimin ndërinstitucional.

Rruga "Papa Gjon Pali II", No.3
info@cesk.gov.al
Autoriteti Kombëtar për CESK
autoriteti_kombetar_cesk
+35542221039

BULETIN JAVOR
4-8 SHTATOR 2023

Shprehja e javës

"Nuk ka asnjë tekologji sot që nuk mund të mposhtet nga inxhinieria Sociale"

Frank Abagnale

Përmbajtja:



Sulmuesit ransomware synojnë bazat e të dhënave të ekspozuara të Microsoft SQL

SStudiuesit Securonix kanë identifikuar një fushatë në të cilën sulmuesit po shfrytëzojnë serverët e Microsoft SQL (MSSQL) për të ofruar Cobalt Strike dhe një lloj ransomware të quajtur FreeWorld duke përdorur sulme bruteforce.

Securonix nuk ia atribuoi sulmet ndonjë grupi të njohur kriminal, por zbuloi se FreeWorld ishte një variant i ri i ransomware Mimik i parë për herë të parë në qershor 2022. Securonix këshillon përdoruesit e bazave të të dhënave të Microsoft SQL që të mos i ekspozojnë ato në internet.

Link: Lexo më shumë

Dy vulnerabilitete në Apache SuperSet lejojnë hakimin e serverave në distancë

Apache Superset është një platformë për Vizualizimin dhe Eksplorimin e të Dhënave me burim të hapur bazuar në framewokun Flask Web. Versioni 2.1.1 adresoi dy dobësi, të gjurmuara si CVE-2023-39265 dhe CVE-2023-37941, që mund të shfrytëzoheshin për të fituar kontrollin e bazës së të dhënave Superset.

Ekspertët vunë re gjithashtu se disa instalime Superset, të tilla si docker-compose, përdorin kredencialet e paracaktuara për të hyrë në bazën e të dhënave. Një sulmues që njeh kredencialet e paracaktuar mund të lidhet me bazën e të dhënave dhe të fitojë kontrollin mbi të.

Link:Lexo më shumë

Freecycle konfirmon një incident kibernetik që ka prekur 7 milionë përdorues

Më shumë se shtatë milionë njerëz u prekën nga një shkelje e sigurisë që ndodhi në serverët e Freecycle, një forum në internet i dedikuar për shkëmbimin e sendeve të përdorur. Sipas Freecycle, informacioni i vjedhur përfshin emrat e përdoruesve, ID-të e përdoruesve, adresat e emailit dhe fjalëkalimet e hashuara.

Organizata njoftoi se ka raportuar incidentin tek autoritetet përkatëse dhe këshillon përdoruesit e saj të ndryshojnë fjalëkalimet e tyre, të jenë vigjilentë ndaj emaileve, të shmangin klikimin në linqet e bashkangjitura në email dhe të mos shkarkojnë dokumentet e bashkangjitura nëse nuk janë të sigurt për origjinën e tyre.

Link: Lexo më shumë

PATCHING ALERT

Cisco *patchon* vulnerabilitetin kritik në platformën BroadWorks

E gjurmuar si CVE-2023-20238, cenueshmëria që prek platformën e thirrjeve dhe bashkëpunimit BroadWorks mund të shfrytëzohet nga sulmues të largët dhe të paautentikuar për të falsifikuar kredencialet dhe për të fituar akses në sistemet e prekura.
Dobësia prek vetëm versionet 3.1 dhe 3.2 të Cisco ISE dhe u rregullua me lëshimin e versioneve 3.1P7 dhe 3.2P3 të Cisco ISE.

Gjiganti i teknologjisë njoftoi se nuk është në dijeni të ndonjë prej këtyre dobësive duke u shfrytëzuar në sulme me qëllim të keq.

Link:Lexo më shumë

Rruga "Papa Gjon Pali II", No.3
info@cesk.gov.al
Autoriteti Kombëtar për CESK
autoriteti_kombetar_cesk
+35542221039